

STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMIT

“Edu logistic”sh.p.k

Në bazën e kërkesave të ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit nr. 9723 të dates 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” sot me date ___/___/2023 krijohet Shoqëria tregtare “Edu logistic” sh.p.k, e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI 1

EMËRTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE THEMELUESIT

1.1 Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar “Edu logistic” sh.p.k me ortak të vetëm:

- Ortaku **FONDACIONI “GREEN EDUCATION”** i regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.vendimi 597 datë 18.04.2017 me seli në Rrugën “Punëtorët e Rilindjes” pallati nr.1, Shk. 2 ap.4 Tiranë, Shqipëri me nipt: M01713451H.

NENI 2

SELIA

2.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rruga “Bashkim Shkurti” ndërtesa me nr.pasurie 16/28,zona kadastrale 2679, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria mund të çelë seli të tjera të dyta, degë përfaqësimi apo agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 3

KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e saj me një afat kohor të pacaktuar. Shoqëria mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të ortakut.

NENI 4

VULA


4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj, me emrin “Edu Logistic” sh.p.k dhe niptin.

NENI 5

OBJEKTI

5.1 Shoqëria ka si objekt aktivitetin si vijon:

- 5.1.1 Ofrimin e të gjitha llojeve të transportit të udhëtarëve që parashikon legjislacioni shqiptar brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

melife
23

5.1.2 Ofrimi i shërbimeve si agjensi turistike:

- a) Ushtrimi i aktiviteteve në fushën e turizmit dhe të udhëtimeve të transportit turistik.
- b) Organizimin e udhëtimeve dhe pushimeve individuale ose kolektive për shtetasit shqiptar dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit dhe ndërmjetesimin për shitjen e produkteve turistike në të gjitha format e tij.
- c) Shërbime që mund të ofrohen në rastin e udhëtimeve dhe pushimeve si: Rezervim i vendeve të fjetjes në njësitë akomoduese turistike si hotele, vila etj. Rezervimi dhe shitja e biletave për linjat ajrore, urbane dhe detare etj. Rezervimi i vendeve, mjeteve të transportit turistike. Vënja në dispozicion me qira pjesore ose totale e këtyre mjeteve. Porositja e ushqimit në restorante turistike sipas nevojave të tureve.
- d) Organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente historike-kulturore, natyre etj, brenda dhe jashtë vendit.
- e) Shërbime guidë dhe përkthimi etj.
- f) Dhënia e informacioneve për turizëm, udhëtime, objekte social kulturore etj.
- g) Ndërmjetësim me shitësit kryesorë në produktet turistike.
- h) Dhënia e automjeteve të ndryshme me qira ditore, mujore apo vjetore etj.
- i) Rezervimi dhe prerje të biletave për transportin ajror, rrugor dhe detar me të cilat do të udhëtojnë. Ndjekje e dokumentacionit të nevojshëm për të gjithë procedurat e vizave turistike për të hujat brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu mund të ushtrojë çfarëdolloj aktiviteti plotësues, aksesor, të ngjashëm apo të lidhur si më sipër parashikuar.

KAPITULLI II KAPITALI

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (njëqind) lekë i cili miratohet nga ortaku i vetëm themelues dhe ndahet në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të barabartë me 100 lekë (njëqind) lekë që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

6.2 Kapitali i ortakut të vetëm themelues është si më poshtë:

- Ortaku i vetëm **FONDACIONI "GREEN EDUCATION"**, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 100 lekë (njëqind) lekë, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

7.1 Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



NENI 8
TRANSFERIMI I KAPITALIT

8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit fillestar
- b) Shitblerjes
- c) Dhurimit
- d) Trashëgimisë
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Ortakët mund të shesin pjesërisht apo tërësisht kuotat e tyre të kapitalit. Shitja e kuotave tek të tretët bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim Asambleja e Ortakëve dhe nëpërmjet kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

KAPITULLI III
ORGANET DREJTUESE

NENI 9
ORGANET DREJTUESE

9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

NENI 10
ORGANI VENDIMARRËS

10.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë, ortakët vendosin mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njëri apo disa prej administratorëve i paraqesin për miratim.

NENI 11
AKTET DHE VERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

11.1 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

11.2 Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Presidentit dhe i cili e mban procesverbalin, rezultatet e votimit.

11.3 Procesverbali i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë ortakët e pranishëm dhe nga ai që e përpilon atë.

NENI 12
ADMINISTRIMI



12.1 Asambleja e Ortakëve vendos që administrimi i shoqërisë i cili konsiston në kryerjen e të gjithë veprimeve të administrimit për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, i besohet një administratorit të vetëm.

12.2 Me themelimin e Shoqërisë, emërohet Administrator Z. SAMET BEGU

NENI 13

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

13.1 Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka të drejtë që ta përfaqësojë atë në marrëdhënie me të tretë.

NENI 14

PËRFAQËSIMI I ADMINISTRATORIT

14.1 Administratori ka të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim.

Ai mund të caktojë avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta apo kategori aktesh.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR

NENI 15

VITI FINANCIAR

15.1 Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj në organet tatimore, ndërsa për vitet në vijim nis nga data 1 janar deri më 31 dhejtor të çdo viti.

15.2 Në fund të çdo periudhe të ushtrimit të aktivitetit hartohet bilanci kontabël, brenda afateve dhe konform ligjeve në fuqi.

15.3 Dokumentet e kontabilitetit, të shoqëruar nëse është e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabël të autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakëve dhe të vihen në dispozicionin e tyre pranë selisë së shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së Mbledhjes së Asamblesë.

15.4 Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse të saj si dhe librat kontabël në përputhje me kërkesat e e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave të tjera fiskale në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16

MARRËDHËNIET E PUNËS

16.1 Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave të punës dhe konform Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

NENI 17

FITIMET

17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve pasi janë zbritur nga kjo shumë vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5 % (pesë përqind) që destinohen për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur kufirin e parashikuar nga ligji.



NENI 18
FINANCIMI I ORTAKËVE

18.1 Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë.

NENI 19
MBYLLJA E AKTIVITETIT

19.1 Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë kur:

- Veprimtaria e shoqërisë është negative për të paktën 3 vite rrjesht.
- Veprimtaria e shoqërisë është e pamundur për të vijuar
- Shpërndalet me vullnetin e lire të ortakëve
- Riorganizohet në një formë tjetër
- Si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj.

NENI 20
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

20.1 Për çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë statut reference janë dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21
DISPOZITA FINALE

21.1 Ky statut u hartua në 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe pasi u miratua në parim nen për nen nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

FONDACIONI "GREEN EDUCATION"

DREJTOR EKZEKUTIV
TAHIR ZENELHASANI

